


REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 Detyra e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
 Ministry of Finance
 Arkivo - Arhivo - Archive

№. i Dokumentit / Doc. No. / 2676-1/2022
 Nr. i Detyrës / No. of Order / 21.11.2022
 Prishtinë / Pristina



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 Detyra e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
 Ministry of Finance
 Arkivo - Arhivo - Archive

№. i Dokumentit / Doc. No. / 1053
 Nr. i Detyrës / No. of Order / 4
 Prishtinë / Pristina

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada- Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers
Departamenti i Buxhetit- Budget Departament - Budzet Departament

| | |
|-------------------------------|---|
| DATË | 21.11.2022 |
| REFERENCË | |
| PËR/ZA/TO: | Z. Naim Shala, Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Punëve Brendshme |
| CC: | Znj. Fahrrije Tërnavë, Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Punëve të Brendshme |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Z. Enis Spahiu, zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve |
| NGA/OD/FROM: | Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinioni i Departamentit të Buxhetit për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor të Projektligjit për pagat në sektorin publik |

I nderuar Z. Shala,

Bazuar në kërkesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) për vlerësimin e ndikimit buxhetor të projektligjit për pagat në sektorin publik, formularit për vlerësimin e ndikimit buxhetor të përgatitur nga Ministria e Punëve të Brendshme, obligimit sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe Nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.

I. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i Projektligjit për pagat në sektorin publik është të krijoj një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik, i cili përfshin parimet dhe rregullat për përcaktimin e pagës në sektorin publik si dhe të krijoj një sistem të pagave dhe shpërblimeve, i cili është transparent dhe i menaxhuar, ku elementi kryesor është paga bazë.

Ky projektligj do të zbatohet për të punësuarit/ve në sektorin publik pagat e të cilëve financohen nga buxheti i shtetit, përjashtimisht Agjencia e Kosovare e Inteligjencës.

Rregullat dhe kushtet e pagesës së të punësuarve në sektorin publik përcaktohen ekskluzivisht me këtë projektligj, por mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht me këtë projektligj.

Për nëpunësit në sistemin e drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, institucionet e tjera kushtetuese dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky projektligj zbatohet për atë që nuk e cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuara me Kushtetutë.

II. OPINIONI PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB) NGA ORGANI PROPOZUES

Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti i Administrimit Shërbimit Civil (Departamenti për Zyrtarin Publik) si organ propozues ka përgatitur vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit për pagat në sektorin publik dhe e ka paraqitur përmes formularit të vlerësimit të ndikimit buxhetor sipas të cilit vlerësohet se zbatimi i aktiviteteve që rrjedhin nga ky projektligj nuk do të krijojë kosto shtesë buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës duke e krahasuar me projeksionet buxhetore për kategorinë e shpenzimeve Paga dhe Shtesa të parapara në Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024-2025.

Përmbajtja e projektligjit për pagat në sektorin publik:

- Ky projektligj përfshin pagat, shtesat, kompensimet dhe shpërblimet për të gjithë të punësuarit në sektorin publik, pagat e të cilëve financohen nga buxheti i shtetit, përjashtimisht Agjencisë Kosovare të Inteligjencës.
- Vlera monetare e koeficientit përcaktohet me ligjin vjetor të buxhetit. Përcaktimi i vlerës së koeficientit bëhet në pajtim me legjislacionin për menaxhimin e financave publike.
- Pavarësisht vlerës monetare të koeficientit, në rast se paga bazë është më e vogël se paga minimale, paga bazë vlerësohet të jetë sa paga minimale.

Baza e përlllogaritjes së pagës dhe përbërësit e saj sipas Projektligjit për pagat në sektorin publik:

Sipas Projektligjit për paga në sektorin publik, raporti i koeficientëve do të jetë dy me tetëmbëdhjetë (2:18), të shpërndarë në njëqind e njëmbëdhjetë (111) nivele të koeficientëve, të përcaktuar sipas Shtojcës Nr. 15 të këtij projektligji.

Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij projektligji (neni 22) janë:

- shtesa e veçantë për të zgjedhurit/at;
- shtesa për kushte tregu të punës;
- shtesa e performancës;
- shtesa për kushte specifike të punës;
- shtesa për punën pa orar të paracaktuar;
- shtesa për vëllimin e punës;
- shtesa për licencë të avancuar për nëpunësin/en e arsimit parauniversitar;
- shtesa për nëpunësin/en e sistemit shëndetësor;
- shtesa e performancës për krijuesin/en dhe performuesin/en e artit dhe kulturës;

- shitesa funksionale;
- shitesa dhe kompensimi i nëpunës/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese rregullohen me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të institucionit përkatës.

Obligime të tjera të përlogaritura në projektligjin për pagat në sektorin publik janë:

- shitesa tranzitore (diferenca mes pagës aktuale dhe pagës së re);
- përvoja e punës;
- kontributi i punëdhënësit ;
- pozitat e aprovuara dhe të paplotësuara sipas ligjit të buxhetit.

Departamenti i Buxhetit, paraqet me sa vijon:

Krahasimi me ndarjet buxhetore:

| Vitet | 2023 | 2024 | 2025 |
|-------------------------|-------------|-------------|-------------|
| Numri i të punësuarve | 88,738 | 88,738 | 88,738 |
| Paga dhe Shtesat (Euro) | 745,528,136 | 749,900,000 | 756,300,000 |

Në vijim do të paraqitet shpalosja e të gjithë elementëve të marrur parasysh në përlogaritjen e kostos së këtij projektligji për vitin 2023:

- Paga bazë: 598,849,428 euro ;
- Shtesat: 13,799,258 euro ;
- Kompensimet: 12,000,000 euro ;
- Shpërblimet: 62,788 euro ;
- Përvoja e punës: 36,000,000 euro ;
- Shtesa tranzitore: 15,000,000 euro ;
- Kontributi i punëdhënësit (5%): 36,421,534 euro ;
- Pozitat e paplotësuara (për 4,177 pozita): 26,846,414 euro;
- Kostoja totale e vlerësuar e këtij projektligji për vitin 2023 (pa AKI): 738,979,422 euro;
- Kostoja e përgjithshme e vlerësuar për kategorinë e shpenzimeve Paga dhe Shtesa për vitin 2023 (duke përfshirë AKI): 745,528,136 euro.

Sqarim shitesë: Departamenti i Buxhetit rekomandon që me rastin e hartimit të akteve nënligjore të parapara me këtë projektligj, kostoja e tyre të jetë në harmoni me ndarjet buxhetore.

Përfundim:


Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit vlerëson se Projektligji për pagat në sektorin publik nga aspekti i ndikimit buxhetor nuk do të krijoj kosto shitesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Të gjitha aktivitetet të cilat rrjedhin nga ky Projektligj do të mbulohen nga ndarjet buxhetore të parapara në projeksionet buxhetore për kategorinë e shpenzimeve Paga dhe Shtesa në Projektligjin

mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024-2025.

Përgatitur nga:

Arta Maxhuni, Analist e lartë e buxhetit



Konfirmoi:

Milaim Aliu, Udhëheqës i divizionit të buxhetit qendror

